



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 3591 Prot.

Fier, më 21.03.2025.

PROJEKT VENDIM
Nr. 30 , datë 21.03.2025

Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Selim Stafa, fshati Baltëz, Njësia Administrative Dërmënas, i dëmtuar nga zjarri i datës 10.03.2025.

Në mbështetje të nenit 3, pikës 1.1 të nenit 9, dhe nenit 29 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 *“Për Vetëqeverisjen Vendore”*, neni 8 dhe 16 të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 *“Për Mbrojtjen Civile”*, si dhe në zbatim të shkronjave “e” dhe “ë” të pikës 1, të paragrafit III, të V.K.M-së Nr.329 datë 16.05.2012 *“Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”*, kreu III pika 1, për dëmin e shkaktuar nga zjarri i datës 10.03.2025, shkresës zyrtare nr.336/1.prot, datë 18.03.2025 *“Vlerësim dëmi”* të Sektorit të Mbrojtjes Civile dhe Zhvillimit të Projekteve, Këshilli i Qarkut Fier, si dhe Preventivit bashkëlidhur kësaj shkrese, ku ka rezultuar se në banesën e shtetasit Selim Stafa dëmi në orëndi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake është në vlerën **189 000 (njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë) lekë** dhe në konstruksion banese në vlerën **136 586 (njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë**, ndaj bazuar në nenin 54, shkronja“g”,

PROPOZON:

1. Dhënie e ndihmës financiare prej Bashkisë Fier për shtetasin Selim Stafa, në masën **100%**, për dëmet e shkaktuara në orëndi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake, në vlerën prej **189 000 (njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë) lekë**.
2. Dhënie e ndihmës prej Bashkisë Fier në masën **50%**, për dëmet e shkaktuara në anën ndërtimore të banesës, në vlerën prej **68 293 (gjashtëdhjetë e tetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre) lekë**, konform përcaktimeve ligjore të pikës 3, gërmës “ç” *“Përcaktimi i ndihmës financiare”* e VKM nr.329 datë 16.05.2012.
3. Vlera totale financiare e dhënies së ndihmës sipas pikave 1 dhe 2 të këtij projekt vendimi për shtetasin Selim Stafa është në masën **257 293 (dyqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre) lekë**.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit si dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile.

Drejtoria e Mbrojtjes Civile
Nasip **BANI**

Drejtoria Juridike
Esmeralda **KAPLLANAJ**

Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.
Pranvera **ÇINA**

KRYETARI
Armando **SUBASHI**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËS KRYETAR

Vasil **BREGU**

